



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË  
ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 1451 Prot.

Tiranë, më 03.3. 2022

Lënda: Për zhvillimin e provimit të shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit.

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHMË TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**  
Rruga "Naim Frashëri", Nr.37  
Tiranë

**DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

RIER  
**ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE**  
Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr.23  
Tiranë

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", të ndryshuar, vendimit nr. 99, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", të Urdhrit nr. 365, datë 28.12.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për miratimin e Rregullores "Për funksionimin e Komisionit të Provimit të Shtetit dhe procedurat e zhvillimit të provimit të shtetit", të Urdhrit nr. 336, datë 14.07.2011, "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 10, datë 03.04.2015 "Për përmbajtjen dhe formën e licencës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit" i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 8, datë 13.03.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore", Provimet e Shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit do të zhvillohen gjatë muajit Prill 2022, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore, sipas kalendarit të hartuar nga ky institucion.

Në provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit do të pranohen kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 57, të ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Profili ku kandidati do të japë provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit lidhet me programin e studimit të ciklit të parë dhe/ose të ciklit të dytë që ka përfunduar kandidati.

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP), si dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), të marrin masat, sa më poshtë:

1. DPAP në bashkëpunim me DRAP dhe ZVAP të kryejnë regjistrimin e kandidatëve të cilët:
  - a) kanë kryer me sukses praktikën profesionale;
  - b) kanë rezultuar jo të suksesshëm në sezonet e kaluara;
  - c) nuk janë paraqitur në sezonet e mëparshme;
  - d) janë në marrëdhënie pune dhe kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë në fushën e mësuesisë.
2. ZVAP-të plotësojnë listën në format Excel (sipas tabelës 1 bashkëlidhur) me të dhënat e kërkuara për çdo kandidat, si dhe e dërgojnë atë në DRAP brenda datës 15.03.2022.
3. Tabela 1 bashkëlidhur, të plotësohet me të dhëna lidhur me: emrin, atësinë, mbiemrin e kandidatit, Nr. ID, DRAP, ZVAP, ku është regjistruar kandidati, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin, Universitetin ku është kryer programi i studimit "Bachelor", Fakultetin ku është kryer programi i studimit "Bachelor", vitin e fillimit të programit "Bachelor", vitin e mbarimit të programit "Bachelor", emërtimin e diplomës "Bachelor", Universitetin ku është kryer programi i studimit "Master", Fakultetin ku është kryer programi i studimit "Master", vitin e fillimit të studimeve "Master", vitin e mbarimit të studimeve "Master", Lloji i masterit (i shkencave/profesional/DIND/MNP), emërtimin e diplomës "Master", profilin, herën e pjesëmarrjes së kandidatit në provimin e shtetit si dhe specifikimin e rasteve të veçanta që regjistrohen për provimin e shtetit me vërtetim, pa paraqitur diplomën Master.
4. Të dhënat e tabelës 1, duhet të jenë të plotësuara në mënyrë të saktë, të plotë dhe në asnjë rast me shkurtime. Këto të dhëna do t'i shërbejnë QSHA-së edhe për të përgatitur licencat e kandidatëve të suksesshëm në provimin e shtetit, në profilet e mësuesisë.
5. DRAP-et verifikojnë dhe konfirmojnë listën e plotësuar nga ZVAP, si dhe hartojnë listat përfundimtare me kandidatët aplikantë në format Excel, për të gjitha Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar nën juridiksionin e tyre dhe e dërgojnë në DPAP brenda datës 21.03.2022. Kandidatët që nuk plotësojnë kriteret për pjesëmarrje në provimin e shtetit, DRAP nuk i përfshin në listën përfundimtare që do të dërgojë në DPAP.
6. DPAP verifikon listat e dërguara nga DRAP-et, në lidhje me saktësinë e të dhënave dhe plotësimin e kriterëve ligjore nga kandidatët e regjistruar dhe dërgon brenda datës 28.03.2022 listën përfundimtare të kandidatëve, zyrtarisht me postë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe në Drejtorinë e Provimeve të Shtetit në QSHA dhe në adresat elektronike: [novruz.ahmeti@arsimi.gov.al](mailto:novruz.ahmeti@arsimi.gov.al) dhe [seldi.beta@qsha.gov.al](mailto:seldi.beta@qsha.gov.al).
7. QSHA publikon në faqen zyrtare kalendarin dhe listat përfundimtare me orarin e pjesëmarrjes në provimin e shtetit për çdo kandidat.
8. Programet orientuese të provimit të shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit dhe fondi i pyetjeve sipas profileve përkatëse janë në dispozicion të kandidatëve në faqen zyrtare të QSHA-së, në linkun: [http://qsha.gov.al/DPSH/fondet\\_html/mesuesi/mesuesi.html](http://qsha.gov.al/DPSH/fondet_html/mesuesi/mesuesi.html)
9. Kandidatët për provimin e shtetit paraqiten në godinën e QSHA-së në datën e caktuar, 30 minuta para zhvillimit të provimit. Kandidatët duhet të kenë me vete dokumentet e mëposhtme:
  - a) dokument identifikimi (Kartë ID ose Pasaportë),
  - b) kopje të dokumentit të identifikimit,

- c) mandatin e pagesës së tarifës së provimit të shtetit për llogari të QSHA (për të kryer pagesën, kandidatët duhet të shkarkojnë faturën për arkëtim në linkun: <http://qsha.gov.al/DPSH/fatura.html>, në varësi të herës së pjesëmarrjes së tyre në provimin e shtetit).
- d) kopje të diplomave të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve të përfunduara prej tyre.
10. Në mungesë të diplomës së ciklit të dytë të studimeve, kandidati potencial për provim shteti në profesionin e rregulluar të mësuesit duhet të pajiset nga Universiteti me vërtetim ku të specifikohet që ai/ajo:
- ka shlyer të gjitha detyrimet për përfundimin e ciklit të dytë të studimeve në edukim, si dhe njohjen e gjuhës së huaj, në bazë të testimeve të njohura ndërkombëtare dhe në nivelin e specifikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
  - emërtesa e plotë dhe lloji i programit të ciklit të dytë të përfunduar;
  - viti i përfundimit;
  - numri i matrikullimit;
  - data e diplomimit.
11. Kandidatët të cilët nuk paraqesin të plotë dokumentacionin sipas kërkesave të përcaktuara, nuk do të pranohen të marrin pjesë në provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit.

DPAP/DRAP/ZVAP-të janë përgjegjëse për verifikimin e plotësimit të kriteve ligjore, saktësinë e të dhënave të kandidatëve të regjistruar, si dhe respektimin me rigorozitet të kërkesave dhe të afateve të përcaktuara si më sipër.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Alqi KUSHI




Tabela 1

Nr.	Të dhënat që kërkohen		Si duhet të plotësohen	
	Nr.	Emri	Numri rendor	Emri i kandidatit sipas Kartës së Identitetit
	Atësia	Atësia e Kandidatit		Atësia e Kandidatit
	Mbiemri	Mbiemri i kandidatit sipas Kartës së Identitetit		Mbiemri i kandidatit sipas Kartës së Identitetit
	ID (NID)	Numri i kartës së Identitetit		Numri i kartës së Identitetit
	DRAP	Emërtesa e DRAP		Emërtesa e DRAP
	ZVA	Emërtesa e ZVAP		Emërtesa e ZVAP
	Datëlindja	Datëlindja e kandidatit sipas Kartës së Identitetit		Datëlindja e kandidatit sipas Kartës së Identitetit
	Vendlindja	Vendlindja e kandidatit sipas Kartës së Identitetit		Vendlindja e kandidatit sipas Kartës së Identitetit
	Vendbanimi	Vendbanimi e Kandidatit		Vendbanimi e Kandidatit
	Universiteti i kryer Bachelor	Emërtesa e plotë e Universitetit ku është kryer Bachelor, sipas shënimit në Diplomë		Emërtesa e plotë e Universitetit ku është kryer Bachelor, sipas shënimit në Diplomë

Udhëzime për plotësimin e tabelës:

Nr.	Emri	Numri rendor	Emri i kandidatit sipas Kartës së Identitetit	Numri i kartës së Identitetit	Emërtesa e DRAP	Emërtesa e ZVAP	Datëlindja e kandidatit sipas Kartës së Identitetit	Vendlindja e kandidatit sipas Kartës së Identitetit	Vendbanimi e Kandidatit	Emërtesa e plotë e Universitetit ku është kryer Bachelor, sipas shënimit në Diplomë

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: [info@arsimi.gov.al](mailto:info@arsimi.gov.al) [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al)

Fakulteti Bachelor	Emërtesa e plotë e Fakultetit ku është kryer Bachelor, sipas shënimit në Diplomë
Viti i fillimit Bachelor	Data e regjistrimit në Bachelor, sipas shënimit në Diplomën Bachelor
Viti i përfundimit Bachelor	Data e lëshimit në Bachelor, sipas shënimit në Diplomën Bachelor
Emërtimi i Diplomës Bachelor	Emërtesa e plotë e programit të studimit Bachelor, sipas shënimit në Diplomë
Universiteti i kryer Master	Emërtesa e plotë e Universitetit ku është kryer Master, sipas shënimit në Diplomë
Fakulteti Master	Emërtesa e plotë e Fakultetit ku është kryer Master, sipas shënimit në Diplomë
Viti i fillimit Master (Data e regjistrimit)	Data e regjistrimit në Master, sipas shënimit në Diplomën Master
Viti i përfundimit Master (Data e lëshimit)	Data e lëshimit në Master, sipas shënimit në Diplomën Master
Lloji i Masterit (I shkencave/Profesional/DIND/MNP)	Emërtesa e plotë e llojit të Masterit që ka kryer kandidati, e cila mund të jetë Master (I shkencave/Profesional/DIND/MNP)
Emërtimi i Diplomës Master	Emërtesa e plotë e programit të studimit Master, sipas shënimit në Diplomë
Profili	Profili për të cilin do të japë provimin e shtetit
Hera e pjesëmarrjes	Të specifikohet me numër hera e pjesëmarrjes së kandidatit në provimin e shtetit
Shënime (vetëm për kandidatët që regjistrohen me vërtetim)	Vendos shënimin "Me vërtetim", vetëm për kandidatët që regjistrohen me vërtetim

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: [info@arsimi.gov.al](mailto:info@arsimi.gov.al) [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al)